

1021

11.09.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT ELBASAN

Nr 586 ProtElbasan më, 11 .09 .2025

VENDIM

Nr 39 , datë 10 .09 .2025**“PËR MIRATIMIN E “PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE URBANE NË BASHKINË GRAMSH, 2025-2030”**

Në mbështetje të:

Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 13, pika 7, amenduar me Ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për manaxhimin e mbetjeve të rrezikshme”, Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, V.K.M nr.319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve, VKM nr. 428, datë 08.06.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale vend depozitimeve të mbetjeve urbane”, VKM nr. 687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", VKM nr. 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", VKM nr. 387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura, VKM nr. 127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura", VKM nr. 641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte ", VKM nr. 608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre", VKM nr. 579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve", VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr. 371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre, VKM nr. 229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", VKM nr. 52, datë 05/02.2014 për disa ndryshime në Vendimin Nr.117, datë 13/02/2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje", VKM nr. 117, datë 13/02/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje", VKM nr. 957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", VKM nr. 866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre", VKM nr. 765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura", VKM nr. 705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës". VKM nr. 452, datë 11/07/2012 "Për Landfill-et e mbetjeve", VKM nr. 177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", VKM nr. 178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve", VKM nr. 175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve", VKM nr. 798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore", VKM nr. 99, datë 18/02/2005

Adresa: Lagjia "Brig.17 Sulmuese", Rruga "Q.Stafa", www.qarkuelbasan.gov.al; email: info@qarkuelbasan.gov.al

"Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve", Udhezimi nr.1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studimit -projektimit për rehabilitimin e vend - depozitimeve të mbetjeve të ngruta urbane si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impjanteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane", VKB Nr.79, datë 09.09.2025 "Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve të Integruara urbane në Bashkinë Gramsh", shkresës Nr.3238/3 prot datë 09.09.2025 të Bashkisë Gramsh "Kërkesë për miratim nga Këshilli i Qarkut Elbasan",

me propozim të Grupit të Menaxhimit Strategjik, Këshilli i Qarkut Elbasan në mbledhjen e datës 10.09.2025:

VENDOSI:

- 1.Të miratojë "Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane (PVMIMU) 2025-2030, në Bashkinë Gramsh", bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike për zbatimin e këtij vendimi.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Ermira URUPI

